

PROKURORIA E PËRGJITHSHME
Nr. 68/58 Prot.
Datë 05.07.2021
DREJTORIA Joni O. Jushi



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PROKURORIA PRANË GJYKATËS SË APELIT
GJIROKASTËR

Nr. 18/1 Prot (GJ.F)

Gjirokastër më 01.07.2021

Lënda: Kthim Pergjigje.

Drejtuar: PROKURORISË SË PËRGJITHSHME
PROKURORI I PËRGJITHSHËM

Në përgjigje të shkresës Tuaj Nr.68 prot. datë 14.01.2021 "Per paraqitjen e raportit vjetor 2020", ju ridergojme një kopje të raportit vjetor 2020, raport i cili është dërguar elektronikisht në dt.09.03.2021.

Bashkëlidhur shkresës ju dergojmë një kopje të email të datës 09.03.2021.

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin!

DREJTUESI I PROKURORISË SË APELIT

Gjon Fusha



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PROKURORIA PRANË GJYKATËS SË APELIT
GJIROKASTËR

ANALIZA

MBI TREGUESIT E PUNËS SË KRYER GJATË VITIT 2020

Prokuroria pranë Gjykatës së Apelit Gjirokastrë, në zbatim të kërkesave të legjislacionit penal dhe procedural penal, urdhërat dhe udhëzimet e Prokurorit të Përgjithshëm, Rezolutës së Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, Rekomandimeve Prioritare të Këshillit të Ministrave dhe akteve ligjore në zbatim të tyre, si dhe akteve të tjera ligjore dhe nënligjore që normojnë veprimtarinë e saj, si organ i procedimit penal, ka përmbushur për periudhën 01 Janar-31 Dhjetor 2020, detyrat e saj në fazën e gjykimit dhe ekzekutimit të vendimeve penale.

Treguesit e përgjithshëm.

Prokuroria pranë Gjykatës së Apelit Gjirokastrë, duke ju referuar shqyrtimeve gjyqësore të ankimeve të ardhura nga Prokuroritë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë, Gjirokastrë, Sarandë dhe Përmet, gjatë vitit 2020, ka shqyrtuar 73 çështje themeli (32 çështje më pak se viti kaluar), me 91 të pandehur (43 më pak se viti kaluar), nga të cilët 58 me masë sigurimi “arrest burg”.

Janë shqyrtuar 138 (47 më shumë se viti kaluar) çështje me 262 (140 më shumë se viti kaluar) persona të dyshuar, me objekt vleftësim arresti ose ndalimi dhe caktim mase sigurimi.

Gjithashtu në Gjykatën e Apelit Gjirokastrë, janë shqyrtuar dhe 52 çështje penale me objekt gjykim i kërkesë për prishjen e vendimit të mosfillimit, rivendosje në afat, me të dëmtuar akuzues, kundërshtim zgjatje afati paraburgimi, hetimi etj (9 më shumë se viti kaluar).

Nga viti 2020, janë mbartur për vitin 2021 gjithësej 91 çështje.

Nga Prokuroria e Apelit Gjirokastrë gjatë vitit 2020, nuk është ushtruar asnjë rekurs në Gjykatën e Lartë.

Janë nxjerrë dhe 17 Urdhëra ekzekutimi.

Treguesit për vendime themeli.

Duke ju referuar shqyrtimeve gjyqësore të themelit, rezulton se janë shqyrtuar:

33 çështje, me 41 të pandehur, nga të cilët 19 me masë sigurimi “Arrest në burg” që i përkasin Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë, Gjirokastrë; 36 çështje, me 46 të pandehur, nga të cilët 39 të pandehur me masë sigurimi “Arrest në burg” që i përkasin Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Sarandë si dhe 4 çështje, me 4 të pandehur, pa masë sigurimi “Arrest në burg” që i përkasin Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë, Përmet.

Duke ju referuar shqyrtimeve gjyqësore të themelit, rezulton se 9 apeline (9 apeline më pak se viti 2019), janë ushtruar nga Prokurorët, ku 3 apeline janë bërë për vendime pafajësie, 6 apeline janë bërë për masa dënimi të buta dhe asnjë apelim për ndryshim kualifikimi. Është hequr dorë nga apeli i prokurorëve të shkallës së parë në 2 raste. Nga Prokuroria e Apelit, janë përkrahur 7 apeline të Prokurorëve, nga të cilat për 3 apeline për pafajësi, nga Gjykata e Apelit është lënë në fuqi vendimi i pafajësisë, 1 rënduar pozita e të pandehurit dhe në 3 raste të tjera është lënë në fuqi vendimi i shkallës së parë.

Nga të pandehurit janë ushtruar 75 apeline ndaj vendimeve të gjykatave të shkallës së parë.

Prokuroria e Apelit Gjirokastrë në 75(2 më pak se viti kaluar) raste të ushtrimit të apelit, për 61 raste ka kërkuar lënien në fuqi të vendimeve të Gjykatave të Shkallëve të Para. Nga gjykata janë lënë në fuqi 56 vendime, në 3 vendime është vendosur lehtësimi pozitës së të pandehurit në dënime më të buta, në 1 vendim(1 më pak nga viti kaluar) është dhënë pafajsi dhe në 1 rast është vendosur kthimi i akteve.

Për vitin 2020, nuk është ushtruar asnjë rekurs në Gjykatën e Lartë.

Treguesit e vendimeve për masa sigurimi.

Përsa u përket masave të sigurimit, nga 138 apeline (47 më shumë se viti kaluar), 33(18 më shumë nga viti kaluar) apeline janë bërë nga prokuroritë e rretheve gjyqësore dhe 172(78 më shumë nga viti kaluar) apeline janë bërë nga personat e dyshuar.

Nga apelimet e prokurorëve, në 9 raste është hequr dorë nga prokurori Apelit dhe në 23 apeline të Prokurorëve, janë pranuar nga gjykata e Apelit 9 apeline, rënduar pozitën, duke caktuar ndaj tyre masën e sigurisë “Arrest në burg” sipas ankimit të prokurorit, në 11 gjykime është miratuar vendimi gjykatës së shkallës së parë për caktim masë sigurimi dhe në tre raste Gjykata e Apelit, ka ndryshuar masën e sigurimit, duke caktuar masë sigurimi më të butë.

Nga 172(78 më shumë nga viti kaluar) apeline të personave të dyshuar ndaj masës së sigurimit(arrestit në burg), Gjykata e Apelit, ka vendosur miratimin e vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë për 129 raste nga 138 kërkesa të prokurorit të apelit për miratimin e vendimit të caktimit të masës së sigurimit dhe ka ndryshuar vendimin duke caktuar masë sigurimi më të butë sipas kërkesës së të dyshuarve në 5 raste.

Nga Prokuroria e Apelit, nuk është ushtruar asnjë rekurs në Gjykatën e Lartë.

Dinamika e çeshtjeve sipas prokurorive.

Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë, Gjirokastrë:

Nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë, Gjirokastrë, janë apeluar 33 vendime themeli (7 më pak se viti kaluar) me 41 të pandehur, nga të cilët 19 me masë sigurimi “Arrest në burg”. Nga këto 2(8 më pak se viti kaluar) apeline janë ushtruar nga Prokurorët dhe 36 vendime janë apeluar nga të pandehurit (2 më shumë se viti kaluar), pra Prokuroria e Gjirokastrës, ka apeluar 2 vendime themeli, nga të cilët, 1 për pafajësi dhe 1 ankim ndaj vendimit të masës dënimit të butë. Të pandehurit kanë apeluar 36 vendime. Nga Prokurori Apelit janë bërë 29 kërkesa për lënie në fuqi të vendimit, ku Gjykata e Apelit në 25 vendime, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë, në 3 vendime ka lehtësuar pozitën e të pandehurve dhe në 1 vendim, ka vendosur pafajësi. Nga 2 apeline të Prokurorisë Gjirokastrë për rëndim të pozitës së të pandehurit, Gjykata e Apelit ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë.

Nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë, Gjirokastrë, janë ushtruar 75 apeline ndaj vendimit për caktimin e masës së sigurimit (25 apeline më shumë se viti kaluar), ku 14 (3 më shumë nga viti kaluar) apeline janë ushtruar nga Prokuroria dhe 84 apeline janë ushtruar nga personat e dyshuar, të arrestuar ose ndaluar. Në 12 raste të apelit të Prokurorisë Gjirokastrë, është përkrahur ankimi i prokurorit për ndryshimin e vendimit të caktimit të masës së sigurimit për rëndimin e pozitës së të dyshuarit, kurse Gjykata e Apelit në 4 raste ka ndryshuar vendimin e Gjykatës së Shkallës së Parë, duke vendosur sipas kërkesës së prokurorit për të rënduar pozitën, ndërsa në tetë raste, ka miratuar vendimin e gjykatës.

Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë, Sarandë:

Nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë, Sarandë, janë apeluar 36 vendime themeli (21 më pak se viti kaluar) me 46 të pandehur, nga të cilët 39 me masë sigurimi "Arrest në burg". Nga këto 6 (1 më pak se viti kaluar) apeline, janë ushtruar nga Prokurorët dhe 36 vendime janë apeluar nga të pandehurit (22 më pak se viti kaluar), pra Prokuroria e Rrethit Sarandë ka apeluar 6 vendime themeli, nga të cilat, 2 për pafajsi dhe 4 ankime ndaj vendimit të masës dënimit të butë. Të pandehurit kanë apeluar 36 vendime. Nga Prokurori Apelit janë bërë 28 kërkesa për lënie në fuqi të vendimit, ku Gjykata e Apelit në 27 vendime ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë, në 1 rast, ka ndryshuar vendimin e gjykatës, duke dhënë pafajësi. Nga 6 apeline të Prokurorisë Sarandë për rëndim të pozitës së të pandehurit, Gjykata e Apelit ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë.

Nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë, Sarandë, janë ushtruar 42 apeline ndaj vendimit për caktimin e masës së sigurimit (21 apeline më shumë se viti kaluar), ku 2 (2 më shumë nga viti kaluar) apeline janë ushtruar nga Prokuroria dhe 44 apeline janë ushtruar nga personat e dyshuar, të arrestuar ose ndaluar. Në 2 raste të apelit të Prokurorisë Sarandë, është përkrahur ankimi i prokurorit për ndryshimin e vendimit të caktimit të masës së sigurimit, në një rast, për rëndimin e pozitës së të dyshuarit, ku Gjykata e Apelit ka ndryshuar vendimin e Gjykatës së Shkallës së Parë, duke vendosur sipas kërkesës së prokurorit për të rënduar pozitën. Për rastin tjetër është lehtësuar pozita e të dyshuarit.

Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë, Përmet:

Nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë, Përmet, janë apeluar 4 vendime themeli (5 më pak se viti kaluar) me 4 të pandehur, nga të cilët nuk ka pasur asnjë të arrestuar me masë sigurimi "Arrest në burg". Nga këto 1 (sa viti kaluar) apelim është ushtruar nga Prokurorët dhe 3 vendime janë apeluar nga të pandehurit (4 më pak se viti kaluar), pra Prokuroria e Përmetit, ka apeluar 1 vendim themeli, ndaj vendimit të masës dënimi të butë. Të pandehurit kanë apeluar 3 vendime. Nga Prokurori Apelit janë bërë 3 kërkesa për lënie në fuqi të vendimit, ku Gjykata e Apelit në 2 vendime ka vendosur lënie në fuqi të vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë, në 1 rast ka prishur vendimin duke kthyer aktet dhe në rastin tjetër ka rënduar pozitën e të pandehurit sipas kërkesës së prokurorit.

Nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë, Përmet, janë ushtruar 21 apeline ndaj vendimit për caktimin e masës së sigurimit (5 apeline më shumë se viti kaluar), ku 17 (14 më shumë nga viti kaluar) apeline janë ushtruar nga Prokuroria dhe 44 apeline janë ushtruar nga personat e dyshuar, të arrestuar ose ndaluar. Në 14 raste të apelit të Prokurorisë së Rrethit Përmet, nga Prokuroria e Apelit, janë përkrahur ankimet e prokurorit për ndryshimin e vendimit të caktimit të masës së sigurimit, për rëndimin e pozitës së të

dysshuarit në 7 raste, 1 rast zbutjen e masës së sigurimit dhe 6 raste ka hequr dorë nga ankimi, kurse Gjykata e Apelit në 4 raste ka ndryshuar vendimin e Gjykatës së Shkallës së Parë, Përmet, duke vendosur sipas kërkesës së prokurorit për të rënduar pozitën e të dysshuarit, ndërsa në tetë raste, ka miratuar vendimin e gjykatës dhe në një rast, ka zbutur llojin e masës së sigurimit.

Vendimet e apeluara për vitin 2020 krahasuar me apelimet për vitin 2019

Në krahasim me vitin e kaluar, gjatë vitit 2020, në Gjykatën e Apelit Gjirokastrë janë shqyrtuar 262 çështje (26 ankime me shumë se vitin e kaluar), duke përfshirë ankimet ndaj vendimeve të themelit, ankimet ndaj masave të sigurimit si dhe ankimet e çështjeve që nuk pasqyrohen në statistikë (kundërshtim vendim/mosfillimi, rivendosje në afat, zgjatje afati hetimi dhe paraburgimi, sigurim prove, lirim para kohe me kusht kërkesa për ekstraime etj).

Rrastet e gjykuara sipas dinamikës së veprave penale, janë si më poshtë:

- Për nenin 283 të K.Penal (Prodhimi dhe shitja e narkotikëve), gjithësej janë shqyrtuar 33 apeline (9 apeline më shumë se viti kaluar), nga të cilat 2 apeline janë ushtruar nga prokurorët, të cilat janë apeline për masa të buta dënimi, kurse nga Gjykata e Apelit, janë lënë në fuqi vendimet e Gjykatës së Shkallës së Parë.
- Për nenin 284 të K.Penal (Kultivimi i narkotikëve), janë shqyrtuar nga gjykata e apelit 3 ankime, një ankim i ushtruar nga prokurori për të rënduar pozitën e të pandehurit, ankim i cili është pranuar nga gjykata, duke rënduar pozitën dhe tre ankime të ushtruara nga të pandehurit për zbutjen e masës së dënimit dhe gjykata e apelit ka lënë në fuqi vendimet e gjykatës.
- Për nenin 134 të K.Penal (Vjedhja) janë shqyrtuar 10 apeline, me 10 të pandehur, të cilët kanë kërkuar zbutjen e masës së dënimit dhe gjykata e apelit ka lënë në fuqi vendimet e gjykatës.
- Për nenin 248 të K.Penal (Shpërdorimi detyrës) janë shqyrtuar 2 çështje penale me dy ankime të ushtruara nga të pandehurit për zbutjen e masës së dënimit dhe gjykata e apelit për njërin ankim, ka zbutur masën e dënimit, ndërsa për tjetrin ankim, ka lënë në fuqi vendimin e gjykatës.
- Për nenin 242 të K.Penal (Mosbindja ndaj urdhërit të punonjësit të policisë së rendit publik) janë shqyrtuar 2 apeline të ushtruar nga të pandehurit, të cilët kanë kërkuar zbutjen e masës së dënimit dhe gjykata e apelit ka lënë në fuqi vendimet e gjykatës.
- Për nenin 297 të K.Penal (Kalimi i paligjshëm i kufirit shtetëror) është shqyrtuar 1 apelimi i të pandehurit, i cili ka kërkuar pafajësi dhe gjykata e apelit ka lënë në fuqi vendimin e gjykatës.
- Për nenin 291 të K.Penal (Drejtimi automjetit në gjendje të parregullt) janë shqyrtuar 3 apeline të të pandehurve, të cilët kanë kërkuar zbutjen e masës së dënimit dhe gjykata e apelit ka lënë në fuqi vendimet e gjykatës.
- Për nenin 323 të K.Penal (Largimi i të burgosurit nga vendi i qëndrimit) është shqyrtuar 1 apelimi i të pandehurit, i cili ka kërkuar pafajësi dhe gjykata e apelit ka lënë në fuqi vendimin e gjykatës së shkallës së Parë.
- Për nenin 277 të K.Penal (Pengimi për ekzekutimin e vendimit të gjykatës), është shqyrtuar 1 çështje, me 1 apelim të të pandehurit, i cili ka kërkuar pafajësi dhe gjykata e apelit ka lënë në fuqi vendimin e Gjykatës së Shkallës së Parë.
- Për nenin 4 të K.Penal (Dhuna në familje) janë shqyrtuar 4 çështje, me 4 apeline të të pandehurve, të cilët kanë kërkuar zbutjen e masës së dënimit dhe gjykata e apelit ka lënë në fuqi vendimet e gjykatës.

- Për nenin 139 të K.Penal (Vjedhja me dhunë) është shqyrtuar një çështje, me 1 apelim të prokurorit, i cili ka kërkuar ndryshimin e vendimit dhe deklarimin fajtor të të pandehurit, dhe gjykata e apelit ka ndryshuar vendimin dhe deklarimin fajtor të të pandehurit dhe dënimin e tij sipas kërtimeve të prokurorit.
- Për nenin 89 të K.Penal (Plagosja e lehtë me dashje) janë shqyrtuar 2 çështje penale me dy ankime të ushtruara nga të pandehurit për zbutjen e masës së dënimit dhe gjykata e apelit, ka lënë në fuqi vendimet e gjykatës.
- Për nenin 186 të K.Penal (Falsifikimi i dokumentave) është shqyrtuar një çështje, me 1 apelim të të pandehurit, i cili ka kërkuar pafajësi dhe gjykata e apelit ka lënë në fuqi vendimin e Gjykatës së Shkallës Parë.
- Për nenin 290 të K.Penal (Shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor), janë shqyrtuar 2 çështje, me 2 apeline të të pandehurve, të cilët kanë kërkuar pafajësi dhe Gjykata e Apelit ka lënë në fuqi vendimet e Gjykatës së Shkallës Parë.
- Për nenin 278 të K.Penal (Prodhimi dhe mbajtja pa leje të armëve, armëve shpërthyes dhe mundicionit), janë shqyrtuar 2 çështje, 1 apelim i prokurorit, i cili ka kërkuar ndryshimin e vendimit dhe dënimin e pozitës së të pandehurit dhe Gjykata e Apelit ka ndryshuar vendimin, duke renduar pozitën e tij; 1 ankim i të pandehurit, i cili ka kërkuar zbutjen e masës së dënimit dhe Gjykata e Apelit ka zbutur masën e dënimit të dhënë nga gjykata.
- Për nenin 235 të K.Penal (Kundërshtimi i punonjësit që kryen një punë shtetërore), është shqyrtuar 1 çështje, me 1 apelim të të pandehurit, i cili ka kërkuar pafajësi dhe gjykata e apelit ka lënë në fuqi vendimin e Gjykatës së Shkallës Parë.
- Për nenin 78 të K.Penal (Vrasja me paramendim), është shqyrtuar 1 çështje, me 1 apelim të të pandehurit, i cili ka kërkuar pafajësi dhe Gjykata e Apelit ka lënë në fuqi vendimin e Gjykatës së Shkallës Parë.
- Për nenin 79 të K.Penal (Vrasje në rrethana të tjera cilësues) janë shqyrtuar 2 çështje penale me 2 të pandehur, të cilët kanë kërkuar zbutjen e masës së dënimit dhe Gjykata e Apelit, për njërin ankim, ka lënë në fuqi vendimin e gjykatës, kurse për tjetrin, ka zbutur masën e dënimit të dhënë nga Gjykata e Shkallës Parë.
- Për nenin 76 të K.Penal (Vrasja me dashje) është shqyrtuar një çështje, me 1 apelim të prokurorit, i cili ka kërkuar rëndimin e pozitës së të pandehurit dhe Gjykata e Apelit ka lënë në fuqi vendimin e Gjykatës së Shkallës Parë.
- Për nenin 181 të K.Penal (Fshehja e të ardhurave) është shqyrtuar një çështje, me 1 apelim të prokurorit, i cili ka kërkuar rëndimin e pozitës së të pandehurit dhe Gjykata e Apelit ka lënë në fuqi vendimin e Gjykatës së Shkallës Parë.
- Për nenin 298 të K.Penal (Ndihma për kalim të paligjshëm të kufirit) janë shqyrtuar 2 çështje penale me tre ankime të ushtruara nga të pandehurit për zbutjen e masës së dënimit dhe Gjykata e Apelit për njërin ankim ka lënë në fuqi vendimin e gjykatës, kurse për tjetrin, ka zbutur masën e dënimit.
- Për nenin 181 të K.Penal (Vjedhja duke shpërdoruar detyrën), është shqyrtuar një çështje, 1 apelim i të pandehurit, i cili ka kërkuar pafajësi dhe Gjykata e Apelit ka lënë në fuqi vendimin e Gjykatës së Shkallës së Parë.

Dinamika e veprave penale.

Duke parë dinamikën e përhapjes së veprave penale në territorin në të cilin Prokuroria e Apelit Gjirokastër ushtron kompetencat e saj, konstatohet se për një sërë veprash penale, gjithnjë referuar çështjeve penale të ankimuara nga palët, ka pasur një tendencë të lehtë të rënies së krimit, sa i përket veprave penale kundër pasurisë në sferën ekonomike dhe krimet

kundër autoritetit të shtetit, fallsifikimit të dokumentave, krimet në fushën e doganave, krimet kundër shëndetit, krimet seksuale, veprat penale kundër fëmijëve etj.

Po ashtu, është për të theksuar fakti se dinamika e veprave penale kundër rendit dhe sigurisë publike dhe pikërisht atyre që sanksionohen në nenet 278 (Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyesë dhe municionit) e 283 (Prodhimi dhe shitja e narkotikëve) të K.Penal, kanë qënë në të njejtin nivel përhapjeje si dhe në vitin 2019, si dhe ka pasur një rritje të veprave penale kundër sekretit dhe kufirit shtetëror dhe më konkretisht të veprës penale të parashikuar nga Neni 298 i K.Penal (Ndihma për kalim të paligjshëm të kufijve), kjo si rezultat i emigrantëve të ardhura nga Lindja e Mesme, të cilët e përdorin vendin tonë si vend tranzit për të shkuar në vendet e BE.

Sa i përket veprës penale të parashikuar nga Neni 284 i K.Penal (Kultivimi i bimëve narkotike), megjithëse ka pësuar rënie, probleme, ka patur lidhur me identifikimin dhe arrestimin e autorëve të kryerjes së kësaj vepre penale, duke bërë që dhe lufta kundër kësaj veprimtarie kriminale të mos jetë në nivelin e kërkuar.

Këto janë disa nga treguesit kryesorë të punës së kryer gjatë vitit 2020 në Prokurorinë e Apelit Gjirokastrë.

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin!

DREJTUESI I PROKURORISË SË APELIT

Gjon FUSHA



Gjon Fusha

From: Gjon Fusha
Sent: Tuesday, March 9, 2021 3:21 PM
To: Thoma Jano
Subject: RE: Mbi analizat vjetore
Attachments: Analiza vjetore 2020.docx

Pershendetje,
Gjeni bashkengjitur ketij emaili Analizen vjetore 2020 te Prokurorise se Apelit Gjirokaster.
Me respect
Gjon Fusha

From: Thoma Jano
Sent: Friday, February 12, 2021 11:24 AM
To: Gjon Fusha; Genti Xholi; Ludovik Dodaj; Lazer Cardaku; Ollga Visi; Erion Cela
Cc: Olsian Cela
Subject: Mbi analizat vjetore

Pershendetje,
Bashkelidhur e-mail per pergatitjen e analizave vjetore
Faleminderit dhe dite te mbare